



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA

SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Date: 29.09.2016

575/2016
10.10.2016

Kolegjumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Sipas nenit 379 të LMD të vjetër, respektivisht nenit 361 të LMD në fuqi, të gjitha kërkesat me karakter detyrimor juridik, të vërtetuara me vendim të plotfuqishëm gjyqësor apo të organeve tjera kompetente, parashkuhen në afat prej 10 viteve, por jo edhe kërkesat ptonësore juridike për të cilat është vendosur me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

A r s y e t i m

Agjencia kosovare e privatizimit në Kosovë, me parashtresën nr.281/2015 datë 15.09.2015, nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik, se sipas nenit 379 të LMD të vjetër, ndërsa sipas nenit 361 të LMD në fuqi, a parashkuhen në afat prej 10 viteve, të gjitha kërkesat detyrimore juridike dhe pronësore juridike, të vërtetuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, apo vetëm kërkesat detyrimore juridike të vërtetuara me vendim gjyqësor të plotfuqishëm. Nga vet faktin se sipas nenit 1.1 të LMD në fuqi, me këtë ligj rregullohen të gjitha marrëdhëniet detyrimore në mes palëve, rezulton se nenit 361 i LMD në fuqi, parashevë parashkrimin e të gjitha kërkesave nga marrëdhëniet e detyrimeve të vërtetuara me vendim të plotfuqishëm gjyqësor apo të

organeve tjera kompetente në afat prej 10 vitesh. LMD i vjetër në këtë drejtëm ka qenë më i qartë, ngase në nenin 1, ka paraparë që me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet e detyrimeve, të cilat krijohen me kontrata, me shkaktimin e dëmit, me fitim të pa bazë, me kryerje të punëve pa autorizim, me dhënien e njëanshme të shprehjes së vullnetit dhe me fakte tjera ligjore të vërtetuara, që do të thotë se ky ligj ka përjashtuar rregullimin e marrëdhënieve pronësore juridike në përgjithësi, respektivisht rregullimin e parashkrimit të kërkesave të tilla të karakterit pronësor të vërtetuara me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, në veçanti.

Përndryshe, aktgjykimi i plotefuqishëm gjyqësor që vërteton të drejtën e pronësisë së dikuj, dhe të drejtën e tij për kthim të sendit të caktuar, si objekt i kësaj të drejte, nuk lidhet as me nenin 379 të LMD të vjetër, e as me nenin 361 të LMD në fuqi, ngase me nenin 37 të ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike pronësore, është paraparë që nuk parashkruhet e drejta e pronarit që të kërkoi dorëzimin e sendit në pronësi, kurse me nenin 93 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, është paraparë që pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit, i cili nuk ka këtë të drejtë posedimi. Andaj kjo e drejtë e pronarit as sipas kësaj dispozite nuk parashkruhet.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016)